"Mbështetja e Bashkisë Kukës në hartimin e Paketës Fiskale, Buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm"

Konteksti

Qëllimi i këtij projekti është forcimi i kapaciteteve të Bashkisë Kukës në lidhje me menaxhimin e financave publike, në vijim të mbështetjes edhe në procesin e hartimit të planit strategjik.

Gjithashtu, projekti synon të ndihmojë bashkinë në hartimin e programit buxhetor afatmesëm si dhe në përgatitjen e buxhetit vjetor dhe paketës fiskale, duke u mbështetur në dokumentin e planifikimit strategjik.

Gjatë hartimit të PBA-së, bashkia duhet të arrijë objektivat strategjike duke harmonizuar politikat me burimet e saj financiare të disponueshme, jo vetëm për vitin e ardhshëm, por në afat të mesëm. Procesi i përgatitjes së buxhetit do të integrojë prioritetet strategjike të Planit Strategjik.

Metodologjia

Procesi i planifikimit të buxhetit do të kërkojë shqyrtimin e nevojave të të gjitha njësive administrative, me qëllim përmirësimin e standardeve të jetesës të NJQV-ve të varfra, sikurse edhe për t'i drejtuar bashkitë në rrugën e zhvillimit ekonomik. Përgatitja e PBA-së po organizohet si proces transparent i planifikimit të buxhetit për një ushtrim për një periudhë tre-vjeçare. Programet do të klasifikohen me bazë ekonomike dhe sipas burimeve financiare; duke siguruar informacion mbi përbërjen e shpenzimeve të programit përsa i përket pagave, shpenzimeve operative dhe investimeve. Përveç kësaj, kështu bëhet transparente mënyra e financimit të çdo programi, p.sh., nga tarifat, grantet e kushtëzuara, kontributet e palëve të treta, apo nga paratë e taksave. Gjatë hartimit të paketës fiskale, buxhetit vjetor dhe MTBP-së, IKU do të marrë në konsideratë dy dokumente strategjike të bashkisë, hartuar nën mbështetjen e dldp:

a) Plani i zhvillimit strategjik

b) Plani territorial.

Produkte

Rezultatet e projektit do të jenë buxheti vjetor dhe programi buxhetor afatmesëm i cili pasqyron objektivat strategjike të përcaktuara në planet strategjike të bashkisë, duke konsoliduar në këtë mënyrë financat e saj publike si dhe paketa fiskale.

Gjatë gjithë projektit, trajnimet dhe mbështetja e ofruar nga IKU dhe DLDP do të forcojë kapacitetet e burimeve njerëzore të Departamentit të Financës.

Ky proces, është shoqëruar me dëgjesa publike me qytetarët, bizneset dhe shoqërinë civile për planifikimin e të ardhurave, taksave dhe tarifave vendore si dhe për planifikimin e shpenzimeve për periudhën afatmesme; dëgjesat publike në disa raste kanë qenë një praktikë e krijuar për herë të parë përmes këtij procesi, duke i ofruar mundësinë qytetarëve të njohin planifikimin e bashkisë për komunitetin dhe të japin kontributin e tyre në këtë proces.

FAKTET KRYESORE

DONATOR:

- ✓ Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor DLDP

KOHËZGJATJA:

- ✓ Shkurt 2017 – Tetor 2017

PËRFITUES:

- ✓ Bashkia Kukës

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, lobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.